



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2025

PËR

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË INSPEKTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhetë nenit 14 pika 5, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e përbërjes dhe mënyrën e funksionimit të Bordit të Inspektimeve.

2. Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të parashikuara në ligjin për inspektimin dhe në këtë vendim, Bordi udhëhiqet nga këto parime:

- a) Parimi i ligshmërisë;
- b) Parimi i pavareësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- c) Parimi i transparencës dhe informimit;
- ç) Parimi i mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit;
- d) Parimi i objektivitetit;
- dh) Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit administrativ;

3. Çdo çështje që nuk parashikohet në këtë vendim, rregullohet sipas ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

KREU II
ORGANIZIMI, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I BORDIT TË INSPEKTIMIT

1.Bordi i Inspektimeve krijohet pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, si organ bashkërendues dhe funksionon si strukturë e përherershme në përcaktimin e politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, për inspektoratet qendrore, vendore, si dhe për strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Bordi i Inspektimeve ngrihet me urdhër të Kryeministratit dhe ka në përbërje:

- | | |
|---|---------|
| a) Zëvendëskryeministër | Kryetar |
| b) Zëvendësministër në fushën e arsimit | Anëtar |
| c) Zëvendësministër në fushën e territorit dhe mjedisit | Anëtar |
| ç) Zëvendësministër në fushën e turizmit | Anëtar |
| d) Zëvendësministër në fushën e ekonomisë | Anëtar |
| dh) Zëvendësministër në fushën e kulturës | Anëtar |
| e) Zëvendësministër në fushën e inovacionit | Anëtar |
| ë) Zëvendësministër në fushën e tatimeve | Anëtar |
| f) Zëvendësministër në fushën e infrastrukturës dhe energjisë | Anëtar |
| g) Zëvendësministër në fushën e bujqësisë | Anëtar |
| gj) Zëvendësministër në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale | Anëtar |
| h) Ministër në fushën e pushtetit vendor | Anëtar |

3. Kryetari sipas përcaktimit në pikën 2, të këtij kreu caktohet nga Kryeministri. Anëtaret e tjerë të bordit caktohen nga ministrat përkatës, sipas fushave që mbulojnë.

4. Bordi i inspektimeve ushtron detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar sipas nenit 14, pika 3 të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

5.Bordi i inspektimeve ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegiale, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë vendim.

6. Kryetari i Bordit ushtron këto detyra:

- a) cakton datën e zhvillimit të mbledhjes së bordit dhe vendin e ditës së çdo mbledhje;
- b) drejton zhvillimin e mbledhjes së bordit;
- c) mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit teknik të bordit;
- ç) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- d) deklaron dhe u kërkon anëtarëve të bordit, në mbledhjen e radhës, para votimit të çdo çështje për të deklaruar konfliktin e interesit;
- dh) u jep fjalën anëtarëve të bordit për të relatuar për çështjet e ngarkuara.

7.Anëtari i Bordit ushtron këto detyra:

- a) merr pjesë në mbledhjet e Bordit ose njofton kryetarin për mosparaqitjen e tij dhe arsyet e mungesës;
- b) deklaron gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit;
- c) voton për çështjet e rendit të ditës;

- ç) merr fjalën dhe diskuton për çdo temë, objekt diskutimi;
- d) relaton para komisionit çështjen, nëse është anëtari i caktuar si relator;
- dh) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksionit;
- e) nënshkruan vendimin e bordit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

8.Bordi i inspektimeve, mbështetet nga Sekretariati Teknik, përbërja e të cilit caktohet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm.

9.Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) paraqet relacionin lidhur me çështjet që do të trajtohen dhe dokumentacionin përkatës;
- b) vë në dispozicion të anëtarëve të bordit elektronikisht çështjet që do të shqyrtohen në bord, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së mbledhjes;
- c) krijon kushtet përmbarëvajtjen e punës;
- ç) përpilon njoftimet përmblledhjen e bordit;
- d) mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili zbardhet brenda 2 ditëve pune dhe nënshkruhet rregullisht nga anëtarët e bordit dhe sekretariati teknik;
- dh) ngarkon në sistemin elektronik “e-Inspektimi” vendimet e arsyetuara të marra nga bordi.

KREU III THIRRJA E MBLEDHJES SË BORDIT

1.Bordi i Inspektiveve mblidhet sa herë është i nevojshëm shqyrimi i një çështjeje ose rasti, por jo më pak se dy herë në vit. Kërkesa duhet të përbajë qëllimin, çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe materialet përkatëse.

2.Mbledhja e Bordit thirret me nismën e kryetarit të Bordit ose të inspektorit të Përgjithshëm.

3.Çdo anëtar i bordit mund t'i kërkojë me shkrim kryetarit të bordit të thërrasë mbledhjen për çështje specifike dhe emergjente. Kryetari nëse e vlerëson të arsyeshme, thirret mbledhjen e Bordit brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës në Sekretariatin Teknik të Bordit. Kjo mbledhje shqyron çështjen specifike, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, për të cilën është kërkuar mbledhja.

4.Pas marrjes së miratimit nga kryetari i Bordit për thirrjen e mbledhjes së Bordit, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, përvèç rasteve kur ka urgjencë, mbledhjet e Bordit zhvillohen me afat njoftimi më të shkurtër. Sekretariati Teknik i Bordit i dërgon anëtarëve të Bordit me postë elektronike ose me shkrim, njoftimin dhe rendin e ditës përmblledhjen, si dhe materialet që do të shqyrtohen. Data e njoftimit të anëtarit të Bordit do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit.

5. Inspektori i Përgjithshëm ose në mungesë zëvendësi i tij, duhet të jetë i pranishëm në çdo mbledhje të bordit.

6.Mbledhja e Bordit, si rregull, zhvillohet në selinë e Inspektoratit të Përgjithshëm me përjashtim të rasteve kur kryetari i Bordit vendos ndryshe.

7.Sekretariati i Bordit përgatit njoftimin dhe rendin e ditës mbi bazën e materialeve të dorëzuara, si dhe paraqet për konfirmim tek kryetari i Bordit. Materialet që paraqiten për shqyrtim në mbledhje, depozitohen pranë Sekretariatit të Bordit, i cili përgatit nga një kopje për secilin anëtar dhe jua dërgon në formë elektronike ose të printuar.

8.Në rast pamundësie objektive, papajtueshmëri, konflikt interesit ose pengesë ligjore të kryetarit sipas përcaktimeve në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative, veprime përgatitore, thirrja e mbledhjes dhe drejtimi kryhen nga anëtar i Bordit më i vjetër në moshë.

KREU IV

PROCEDURA E MARRJES SË VENDIMEVE DHE E VOTIMIT NË MBLEDHJET E BORDIT

1.Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të bordit. Çdo anëtar i bordit ka të drejtën e një vote. Vendimi është i vlefshëm kur merret me shumicën e thjeshtë të votave. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit të bordit është përcaktuese në marrjen e vendimit dhe voton i fundit. Abstenimi nuk lejohet dhe çdo votë kundër argumentohet në procesverbal. Në rastet kur nuk arrihet kuorumi i nevojshëm, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër, e cila duhet të zhvillohet brenda 5 ditëve.

2.Bordi miraton vendime mbi bazën e dokumenteve të paraqitura përfushëm inspektuese, por në rastet kur e gjykon të nevojshme ai mund të marrë vendime edhe mbi bazën e informacioneve të paraqitura për shqyrtim apo propozimeve të bëra gjatë diskutimit në mbledhje.

3.Mbledhja e bordit sipas pikës 1 të këtij kreua, në raste përashtimore, mund të zhvillohet edhe në distancë (online). Në këtë rast, mënyra e thirrjes, organizimi i mbledhjes dhe vendimet bëhen sipas parashikimit në pikën 1, të këtij kreua.

KREU V

ZBARDHJA DHE MARRJA FUQI E VENDIMEVE TË BORDIT

1.Zbardhja e vendimeve bëhet nga Sekretariati i Bordit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të mbledhjes.

2.Vendimet e nënshkruara depozitohen dhe regjistrohen në një libër të veçantë në zyrën e Protokoll-Arkivit të Inspektoratit të Përgjithshëm. Sekretariati i Bordit dorëzon në protokoll procesverbalin dhe regjistrimet e mbledhjeve të Bordit.

3.Sekretariati i Bordit u dërgon kopje të vendimeve të miratuara strukturave përkatëse, të cilat ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

4.Pas zbardhjes së vendimeve të Bordit të Inspektive, brenda 5 (pesë) ditëve pune, Sekretariati i Bordit i publikon në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm.

KREU VI

LIRIMI DHE SHKARKIMI I KRYETARIT DHE ANËTARIT TË BORDIT

1.Kryetari dhe anëtar i Bordit të Inspektimit liron nga detyra në rastet kur:

a)

- b) jep dorëheqjen;
- c) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson.

2. Kryeministri ka të drejtë të shkarkojë Kryetarin e bordit kur:

- a) nuk merr pjesë, pa arsy, në mbledhjet e Bordit për më shumë se katër herë radhazi;
- b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e Bordit;
- c) nuk përmblidhet funksionet e parashikuara nga ligji dhe ky vendim;
- ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
- d) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;
- dh) për shkaqe sëmundjesh që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
- e) gjatë ushtrimit të funksioneve të tij vepron në kundërshtim me interesat e Bordit.

3. Ministri përgjegjës ka të drejtë të shkarkojë anëtarin e bordit, që është përfaqësues i institucionit që ai drejton, për arsyet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreua dhe ta zëvendësojë me një zëvendësministër tjeter.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministri i linjës fillon procedurën për propozimin e anëtarit të bordit, Kryeministrin sipas pikës 2, kreu 2, të këtij vendimi dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
2. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e fillimit të procedurës për caktimin e anëtarit, organi i emërtës së njofton Kryeministrin për emrin dhe të dhënat e kontaktit të anëtarit që ka caktuar në Bord.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryeministria, ministritë e linjës dhe Inspektorati i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama